e tradhëtorvet, tue dalë të pa larat e tyre sheshit. I Madhi ZOT mbaskëndaj ty të mpron dhe të përgëzon me dëshirat më të mira.

55) D.Xh.Xh. = O çilsi i fatit! I Madhi ZOT (xh. xh.) dëshirat t'i mbaroj po edhe ti bëj durim që të çilen portat e gëzimit. Do të dëgjosh lajme të mira dhe do të gëzohesh si mbas dëshirës.

56) D.A.D. = O çilsi i fatit! Bëj durim se fundja është gëzimi. Po s'bëre durim ké dëm e pendime. Armiq ké shumë po I Madhi ZOT (xh.xh.) të mpron dhe po të bëjsh durim të përgëzon me shpërblime.

57) D.B.D. = O çilsi i fatit! Duhet të punojsh simbas kënaqësisë së Zotit që të shpëtojsh nga sherr i robit dhe nga ngushtësirat lipset të bëjsh mirë që të shohish hajir. Do të fitojsh edhe një [illegible] mirë (inshaell-llahu teala).

58) D.B.A. = O bilbil i fatit! Çdo nevojë do të mbarohet. Ti armikun e ké të keq po prap frikso-hesh si delja nga ujku, I Madhi ZOT mbi ata armiq të bëri galip. Ky qëllim që ke është i mirë me të cilën gëzohesh si mbas dëshirës.

59) D.A.B. = O bilbil i fatit! Ky fat është me dritë. Nevoja të mbarohet dhe nimeti të shtohet. Mbronjs' i vërtetë ty të mpron nga të gjith dëmet. Më tregëti do të shohish shum mirësi, çdo gjë të delë nga dora, e fiton prapë po të bëjsh udhtim e ke hajir dhe çdo punë e ke simbas dëshirës

(inshaall-llahu teala).

60) D.A.Xh. = O bilbil krahë çil! Këtë qëllim të ngushtë lere dhe programin zgjiroje se I Madhi ZOT (Xh.Xh.) ty do të gëzojë si mbas dëshirës dhe do të shpëtojë nga gjith pengimet dhe do të çelë gjith portat e hajirit dhe mbi ty do të heqë fortesë që të jesh në shpëtim prej ç'do syri, gjuhe, dore armiqsore (inshaell-llahu teala).

61) D.B.Xh. = O çilsi i kti fati! Ky fat kallzon: me njeri mos u tako se dëmtohesh. Këtij qëllimi i bëj durim edhe më tej bëj bisedim me njerës të mënshëm e jo oreksorë që të jesh në shpëtim për herë.

62) D.B.A. = O bilbil! Nga ky qëllim që hajir edhe se do udhtime që të bâjish i ké mirë. Sa njerës me dy faqe me ty bëjnë miqsi po fjalët e tyre mos i beso. Ti shëmbllen si Lajmëtari Hazreti Ejjubi që shpëtoj nga provat, ashtu shpëtove edhe ti nga gjith rreziqet.

63) D.Xh.A. = O bilbil! Ky fat ësht si fat i Lajmëtar Hazreti Jusufit, që shënon se ke gëzim, ke udhtim të hajirit. Në zemrën ke dy qëllime po që të dyja janë hajir. Në të ka ikë ngë nga dora të vjen prapë.

64) D.A.Xh. = O bilbil me fat kandil! Ta dijsh se ti me ndihmën e të Madhit ZOT (xhel-le xhelaluh) ke fat edhe murát në të dy jetë dhe armiqët t'uej